



VENDIM

Nr. 12, Datë 25/10/2016

"PËR MIRATIMIN E NOTËS MESATARE, DHE RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE NË DISA PROGRAME STUDIMI, PËR PRANIMET E STUDENTËVE NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË "MASTER I SHKENCAVE", "MASTER I ARTEVE" DHE "MASTER PROFESIONAL" NË FAKULTETIN E MUZIKËS NË UNIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN AKADEMIK 2016 – 2017"

Në zbatim të, nenit 3, (*Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë*), neni 38 (*Funksionet e Senatit Akademik*), neni 39 (*Rektori*), neni 43, neni 69, neni 75, pika 1, e nenit 76, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Dekanatit të FM, me nr. 318 prot. datë 18.10.2016, për miratimin e notës mesatare, për pranimet e studentëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe Vendimit të Dekanatit të FM, me nr. 320 prot. datë 20.10.2016, mbi rishpërndarjen e kuotave të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, në Fakultetin e Muzikës së Universitetit të Arteve për vitin akademik 2016 - 2017, Senati Akademik,

VENDOSI

1. Nota mesatare (totali i notave të studimeve të ciklit të parë bachelor plus diplomën), për pranimet e studentëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Shkencave, Master i Arteve dhe Master Profesional, në Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2016 - 2017, preferohet të jetë 7 (shtatë);
2. Në fakultetin e Muzikës rishpërndarja e kuotave për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Shkencave, Master i Arteve dhe Master Profesional, të jetë sipas tabelës bashkëlidhur;
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës, Sekretaria mësimore e fakultetit dhe Sektori mësimor dhe informimit të studentëve;
4. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve;
5. Kriteri i përcaktuar mbi notën mesatare si kriter hyrës në VSA nr. 11, datë 15.02.2016, të shfuqizohet.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Nansy GJERAZI

Rafael HOXHA